# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5842
E enjte, 1 gusht 2019
çmimi 0.40 €


## Ambasadori i ShBA-së: Ekonomia e Kosovës duhet të rritet 8 për qind

FAQE 9





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", BURIM RAMADANI FAQE 4-5



# Serbia po dërgon mesazhe kërcënuese për tërë Ballkanin

## - Vuçiqi dhe Daçiqi janë kthyer në ushtarë të Putinit kundër NATO-s

Zëvendësministri i Mbrojtjes i Kosovës, Burim Ramadani, ka thënë se Serbia është duke dërguar mesazhe kërcënuese për tërë Ballkanin teksa po armatoset nga Rusia. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo nënkupton që Serbia po e forcon ndërveprueshmërinë e vet ushtarake vetëm me Rusinë. Ai ka thënë se Aleksandar Vuçiqi, Ivica Daçiqi dhe Aleksandar Vulini janë kthyer në ushtarë të Putinit në hakmarrjen ndaj NATO-s në Ballkan. Zëvendësministri Ramadani ka folur edhe për tranzicionin e FSK-së, duke thënë se ky proces po vazhdon dhe do të përmbyllet suksesshëm

# Presidenti thotë se është i gatshëm t'i shpallë zgjedhjet



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka shprehur gatishmërinë për t'i shpallur zgjedhjet e parakohshme nëse subjektet politike nuk janë në gjendje t'i japin përgjigje realiteti të ri politik në një afat të arsyeshëm kohor. Në takimin me kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ai ka thënë se në përputhje me obligimin kushtetues që del nga Neni 95 do t'i shterojë të gjitha mundësitë që në konsultim me partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës të gjendet një përgjigje për realitetin e ri politik FAQE 3




## Ministri Tahiri kërkon nga autoritetet maqedonase që ta lirojnë ish-ushtarin e UÇK-së, Tomor Morina

FAQE 7

## AKTUALE

**POLICIA ARRESTON GJASHTË PERSONA, PJESË E NJË GRUPI KRIMINAL** F. 6

**GAZETARI NUHI BYTYÇI INTERVISTOHET NGA GJYKATA SPECIALE** F. 7

**GLPS-JA: KOSOVA PO NGEC NË IMPLEMENTIMIN E LIGJIT PËR NDIHMË SHTETËRORE** F. 6

**'RAMË LAHAJ AND FRIENDS' SOT MBAJNË KONCERT NË KRYEQYTET** F. 10

## EKONOMI

**ARKEP-I PO ANALIZON SITUATËN E KRIJUAR PAS SHKËPUTJES SË KONTRATËS SË TELEKOMIT ME 'Z-MOBILE'** F. 9




## KULTURË

**MKRS-ja JEP ÇMIMET PËR KINEMATOGRAFI** F. 5

**SNOBIZMI** F. 5

Nga: Shkëlzen UKËHAXHAJ



## SPORT

**SELMANI: PARAQITJA E FERONIKELIT NË EVROPË ISHTE E MIRË** F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Basha: Zgjedhjet e parakohshme, vendim i pakthyeshëm i shqiptarëve

TIRANË, 31 KORRIK - Gjatë takimit me strukturat drejtuese të PD-së në Maliq, kreu i opozitës Lulzim Basha akuzoi kryeministrin Edi Rama si përgjegjës për rritjen e papunësisë dhe varfërisë nëpërmjet politikës së tij të grabitjes, vjedhjes dhe abuzimit me pushtetin. "Shqiptarët janë pa punë, sepse ekonominë dhe mundësitë ekonomike i kanë marrë oligarkët dhe klientët. Paratë e shqiptarëve po i vjedh Edi Rama me familjen dhe miqtë e tij. Pasurohen të pushtetshmit dhe klientët e Ramës, varfërohen njerëzit e thjeshtë dhe të pambrojtur", tha Basha, i cili theksoi se 1 në 3 shqiptarë nuk ka mundësi të ushqehet për shkak të vjedhjes dhe shpërdorimit për luks të parave publike nga Edi Rama dhe qeveria e tij. "Edi Rama i shpërfill shqiptarët, dhunon të pambrojturit e të varfrit dhe u shërben të fortëve dhe oligarkëve. Ai është arrogant me njerëzit e thjeshtë, me intelektualët, me artistët, por është i përulur para kriminelëve dhe oligarkëve", tha Basha.



# Godfrey: Kosova dhe Serbia t'i kthehen dialogut

I emëruari i ShBA-së për ambasador në Serbi, Anthony Godfrey, tha se përparësia e tij, nëse konfirmohet ambasador, do të ishte normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit dhe do t'i inkurajonte të dyja palët të kthehen në tryezën e bisedimeve



UASHINGTON, 31 KORRIK - I emëruari i ShBA-së për ambasador në Serbi, Anthony Godfrey, tha se prioritet i tij do të jetë normalizimi i marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës dhe gjetja e një zgjidhje të qëndrueshme. Diplomati amerikan, i cili ka qenë zëvëndësambasador në Moskë, thotë se është i vetëdijshëm për "ndikimin malinj të Rusisë" dhe thekson se është në interesin strategjik të ShBA-së për ta mbështetur Serbinë në rrugën evropiane.

Anthony Godfrey foli përpara Komitetit për Punë të Jashtme të Senatit, i cili do të duhet ta konfirmojë emërimin e tij, në mënyrë që më pas të votohet nga Senati. "Serbia është një lidere politike dhe ekonomike dhe luan një rol kryesor në stabilitetin rajonal. Është në interesin strategjik të Shteteve të Bashkuara që Serbia të zhvillohet si një vend modern, demokratik dhe evropian dhe ta mbështesim integrimin e saj në BE. Serbia është në një pikë kthese dhe liderët duhet t'i zbatojnë reformat në mënyrë që vendi të shkojë drejt BE-së", tha Godfrey në fjalën e tij, transmeton "Zëri i Amerikës" në gjuhën serbe.

Diplomati amerikan tha se stabiliteti rajonal është parësor dhe se Serbia duhet t'i normalizojë marrëdhëniet me Kosovën në mënyrë që të përparojë drejt anëtarësimit në BE.

Ai potencoi se përparësia e tij, nëse konfirmohet si ambasador, do të ishte normalizimi i marrëdhënieve Beograd - Prishtinë dhe do t'i inkurajonte të dyja palët të kthehen në tryezën e bisedimeve. "Ne po punojmë në këtë drejtim në Beograd, Prishtinë, Uashington dhe Bruksel për të gjetur një mënyrë që Kosova dhe Serbia të vijnë deri te një zgjidhje, t'i shmangin hapat kundërproduktivë që të dyja palët po përdorin. Të dyja palët duhet të ecin përpara dhe është detyra jonë ta mundësojmë këtë", tha Godfrey kur u pyet nga senatorja demokrate, Jeanne Shaheen, se çfarë mund të bëhet në mënyrë që Kosova dhe Serbia të gjejnë një zgjidhje.

Godfrey tha se pas shërbimit diplomatik në Moskë, ai ishte "plotësisht i vetëdijshëm për sjelljen agresive të Rusisë, ndikimin keqdashës dhe fushatën e dezinformimit që ajo po e zhvillon në Evropë" dhe se Shtetet e Bashkuara po bëjnë përpjekje të mëdha për ta kundërshtuar atë.

Senatorja Jeanne Shaheen tha se dorëzimi i fundit i automjeteve luftarake ruse në Serbi është shqetësues në aspekt të dyfishtë - sepse Rusia dëshiron të ndikojë në situatën në Serbi dhe sepse po frikëson vendet e tjera të rajonit, duke pasur parasysh rolin e Serbisë në luftërat e viteve 1990.

Godfrey u përgjigj duke thënë se qëllimi i ShBA-së në Ballkanin Perëndimor është në kundërshtim me qëllimet e Rusisë, por është dakord me qëllimin e Serbisë për t'u integruar në Perëndim dhe do ta inkurajojë Serbinë të lëvizë drejt Perëndimit gjë që, sipas tij, përfshinë edhe normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën.

## Hahn: Shqipërinë e mbajnë peng tri probleme

BRUKSEL, 31 KORRIK - Në deklaratat e tij të mëparshme, diçka ishte nënkuptuar, por në intervistën e dhënë për të përditshmen austriake "Der Standard", komisionari në largim i Zgjerimit, Johannes Hahn, e artikulon qartë preferencën mes vendeve anëtare për një avancim të Maqedonisë së Veriut në drejtim të marrjes së datës së shumëdëshiruar. "Jemi ende duke punuar që t'i çojmë të dy vendet në negociata, por nuk është sekret se ndjesia mes shteteve anëtare për Maqedoninë e Veriut është thjesht më e mirë. Të dy vendet i kanë përmbushur kriteret e kërkuara si kusht nga anëtarët e bllokut. Për këtë arsye, kemi bërë një rekomandim për të dyja. Megjithatë, Maqedonia e Veriut nuk ka arritur vetëm reformat e kërkuara, por edhe marrëveshjen historike të Prespës e, po kështu, edhe traktatin e miqësisë së mirë me Bullgarinë. Për Shqipërinë, për fat të keq, në plan të parë tani janë problemet si mungesa e opozitës në parlament, fakti që qeveria ka vështirësi në mbajtjen e një dialogu, si dhe procedura për shkarkimin e presidentit", tha ai.

I pyetur se sa janë gjasat që Shqipëria ta marrë dritën jeshile, komisionari e pati të vështirë të jepte një përgjigje të drejtpërdrejtë. "Nuk mund ta them me siguri, shpresa ime është që të gjitha forcat politike në Shqipëri ta njohin seriozitetin e situatës dhe të kuptojnë se çfarë po bëjnë me sjelljen e tyre. Sepse popullsia e dëshiron në masën 80 për qind çeljen e negociatave të anëtarësimit, dhe këtë e mbështesin votuesit e të gjitha partive", u shpreh Hahni. Ai nënvizoi, nga ana tjetër, se nëse Maqedonisë së Veriut do t'i lejohet hapja e negociatave në tetor atëherë kjo, sipas tij, do të ndikojë pozitivisht në gjithë rajonin.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të mërkurën në takim kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka

# Presidenti thotë se është i gatshëm t'i shpallë zgjedhjet

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka shprehur gatishmërinë e tij për t'i shpallur zgjedhjet e parakohshme nëse subjektet politike nuk janë në gjendje t'i japin përgjigje realitetit të ri politik në një afat të arsyeshëm kohor. Në takim me kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ai ka thënë se në përputhje me obligimin kushtetues që del nga Neni 95, do t'i shterojë të gjitha mundësitë që në konsultime me partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës të gjendet një përgjigje për realitetin e ri politik



Presidenti Thaçi ka thënë se po shqyrtohen mundësitë që në konsultime me partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës të gjendet zgjidhja më e mirë e mundshme për nxjerrjen e vendit nga kjo situatë e re politike.

Takimet e presidentit Thaçi me përfaqësuesit e partive politike do të vazhdojnë edhe gjatë ditëve të ardhshme. Dje presidenti ka takuar përfaqësuesit e KDTP-së dhe ata të VAKAT nga grupi parlamentar 6+.

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 31 KORRIK - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se do t'i shterojë të gjitha mundësitë që në konsultim me partitë politike parlamentare të gjendet një përgjigje për realitetin e ri politik. Në takim me kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, shefi i shtetit ka vlerësuar se nëse kjo nuk arrihet, atëherë do t'i shpallë zgjedhjet e jashtëzakonshme. "Nëse partitë politike nuk janë në gjendje t'i japin përgjigje këtij realiteti të ri politik në një afat të arsyeshëm kohor, jam i gatshëm t'i shpalli menjëherë zgjedhjet e reja", ka thënë Thaçi. Ai ka shtuar se nga kryetarja Daka është njoftuar se KQZ-ja është e gatshme t'i organizojë zgjedhjet e parakohshme në çdo kohë.

Presidenti Thaçi ka theksuar se është thelbësore që Kosova të ketë qeveri të re, funksionale, efikase, sa më gjithëpërfshirëse dhe sa më të shpejtë, për t'i çuar përpara proceset e rëndësishme.

Kurse kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, pas takimit me presidentin ka thënë se nuk mund të diskutohet për datën e zgjedhjeve të parakohshme pa u shterur të gjitha mundësitë kushtetuese. "Për zgjedhjet e jashtëzakonshme ne gjithmonë kemi opsione", është shprehur kryetarja e KQZ-së. Daka ka bërë me dije se nëse shpallen zgjedhjet atëherë KQZ-ja kërkon mjete nga qeveria për organizmin e këtyre zgjedhjeve pasi, sipas saj, ky vit nuk ka qenë vit zgjedhor.

Gjatë të mërkurës presidenti Thaçi ka vazhduar konsultimet me partitë politike për hapat që duhen ndërmarrë në realitetin e ri të krijuar politik, duke takuar deputetët nga Grupi Parlamentar 6+, Albert Kinollin, i cili është përfaqësues i komunitetit rom, Danush Ademin, përfaqësues i komunitetit ashkali dhe Veton Berishën, përfaqësues i komunitetit egjiptian.

## Partitë politike kërkojnë sa më shpejt caktimin e datës së zgjedhjeve

Subjektet politike sërish kanë kërkuar që zgjedhjet të shpallen sa më shpejt, ndonëse ende nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim në këtë drejtim.

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka bërë me dije se kjo parti ende nuk ka marrë ftesë nga presidenti për konsultime për ta caktuar datën e zgjedhjeve. "Këto vonesa janë të paarsyeshme, duke ditur se vendi nuk ka qeveri efektive. Koalicioni PAN nuk ka pasur legjitimitet tash e një vit për ta qeverisur Kosovën dhe nuk ka as tani për të propozuar një mandatar të ri. Ne do t'i përgjigjemi ftesës së presidentit vetëm për ta caktuar datën e zgjedhjeve. Asnjë temë tjetër nuk mund të diskutohet në këto konsultime", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka shtuar se në mungesë të një iniciative të tillë nga presidenti, LDK-ja do ta kërkojë thirrjen e seancës për shpërbërje të Kuvendit. "Siç parashihet me nenin 83, pika b e Rregullores të Punës të Kuvendit. Në këtë seancë paraprakisht do ta kërkojmë ratifikimin e marrëveshjes IPA me Bashkimin Evropian, e cila Kosovës i sigurojnë fonde rreth 100 mil euro. Është e rëndësishme që këto fonde të mos humben për shkak se Kosova ka pasur një qeveri jolegjitime", ka shkruar Hoti.

Ndërsa deputeti i Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha, ka kërkuar konsensus që Kuvendi i Kosovës të mos shpërndahet para se t'i miratojë edhe 50 projektligje që kanë mbetur në sirtarët e këtij institucioni. "Para se me u shpërnda Kuvendi i Kosovës, pas situatës së re të krijuar nga dorëheqja e Ramushit, është mirë të gjendet një konsensus politik dhe të miratohen mbi 50 ligje që kanë mbetur në sirtarët e Kuvendit. Miratimi i këtyre ligjeve nënkupton edhe arsyetimin e shumave të mëdha financiare që janë shpenzuar gjatë punës që është bërë deri te leximi i dytë", ka shkruar Berisha në profilin e tij në "Facebook".

E deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka shprehur dëshirën e tij që të ndalohen me ligj koalicionet parazgjedhore. Megjithatë, Nitaj ka thënë se në një situatë të tillë personalisht do të përkrahte një koalicion AAK-LDK-PSD. "Po të pyetesha unë, koalicionet parazgjedhore do t'i ndaloja me ligj, por kjo as është e mundur e as nuk ndodh. Kosova, falë një interpretimi të çuditshëm të Gjykatës Kushtetuese, është shndërruar në rob të koalicioneve parazgjedhore. Prandaj koalicionet parazgjedhore edhe këtë herë mund të jenë e keqja e domosdoshme. Dhe në një situatë të tillë dhe nëse ato do të ndodhin, e për të eklipsuar çdo koalicion të mundshëm, për mua joparimor, unë do ta mbështesja një koalicion AAK-LDK-PSD. Natyrisht, ky është qëndrimi im dhe nuk është ofertë publike për koalicion. Siç zakonisht ndodh, vendimet e tilla i merr partia e jo individi", ka shkruar deputeti Nitaj në llogarinë e vet në "Facebook".

## Hoxhaj: Procesi i regjistrimit i popullsisë, i rëndësishëm për Kosovën



PRISHTINË, 31 KORRIK (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka pritur të mërkurën në takim koordinatoren për Zhvillim të OKB-së në Kosovë, Ulrika Richardson. Hoxhaj dhe Richardson në këtë takim kanë diskutuar për rrugë të reja të bashkëpunimit në fusha të ndryshme, me fokus të veçantë për përgatitjet e regjistrimit të popullsisë në vitin 2021. Sipas Hoxhajt, ky proces është mjaft i rëndësishëm për Kosovën.

Flet për "Epokën e re", Burim Ramadani

# Serbia po dërgon mesazhe kë

## - Vuçiqi dhe Daçiqi janë kthyer në ushtarë të Putinit kundër NATO-s



Zëvendësministri i Mbrojtjes i Kosovës, Burim Ramadani, ka thënë se Serbia është duke dërguar mesazhe kërcënuese për tërë Ballkanin teksa po armatoset nga Rusia. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo nënkupton që Serbia po e forcon ndërveprueshmërinë e vet ushtarake vetëm me Rusinë. Ai ka thënë se Aleksandar Vuçiqi, Ivica Daçiqi dhe Aleksandar Vulini janë kthyer në ushtarë të Putinit në hakmarrjen ndaj NATO-s në Ballkan. Zëvendësministri Ramadani ka folur edhe për tranzicionin e FSK-së, duke thënë se ky proces po vazhdon dhe do të përmbyllet suksesshëm

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 31 KORRIK - Zëvendësministri i Mbrojtjes i Kosovës, Burim Ramadani, ka deklaruar se armatosja e Serbisë nga Rusia përbën rrezik për rajonin e Ballkanit. Ai ka thënë se orientimi i Serbisë - si i vetmi vend i rajonit kah Rusia - përbën diçka serioze për këtë rajon. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" Ramadani ka thënë se e vetmja rrugë që e stabilizon sigurinë dhe paqen në Ballkan është modernizimi i shteteve ballkanike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. "Sigurisht se ky është shqetësim serioz për tërë Ballkanin. E vetmja rrugë që e stabilizon sigurinë dhe paqen në Ballkan është modernizimi i shteteve ballkanike, sidomos në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Kur të gjitha shtetet e tjera në rajon ose janë anëtarësuar ose janë drejtuar qartësisht kah NATO-ja, është e vetmja Serbia që ka marrë rrugën e kundërt dhe për këtë rrugë të kundërt është duke u krekosur. Pra, ky orientim kah Rusia i Serbisë është diçka serioz për tërë Ballkanin", ka thënë Ramadani. Ai ka vlerësuar se zyrtarët e lartë të Serbisë janë kthyer në ushtarë të Putinit në hakmarrjen ndaj NATO-s në Ballkan. "Duket krejtësisht qartë se presidenti autoritar i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, trashaluqi Ivica Daçiq dhe karikatura Aleksandar Vulin janë kthyer në ushtarë të Putinit në hakmarrjen ndaj NATO-s në Ballkan. Sigurisht se kjo paraqet shqetësim për të gjithë rajonin, sepse ishin po këta udhëheqës në Beograd që para 20 vjetësh i shërbenin Milloshevigit në veprimet shtetërore gjenocidiale kundër Kosovës dhe Bosnje e Hercegovinës", është shprehur ai.

Zëvendësministri Ramadani ka treguar se cila duhet të jetë përgjigjja e vendeve të tjera të rajonit ndaj armatosjes së Serbisë. "Shtetet properëndimore të Ballkanit duhet ta thellojnë përkushtimin ndaj demokracisë dhe bashkëpunimit rajonal. Nuk duhet të luhaten në asnjë formë në reformat demokratike të brendshme, bashkëpunimin biletaral dhe rajonal, modernizimin e institucioneve të sigurisë, sikurse edhe thellimin e partneritetit me ShBA-në, NATO-n dhe BE-në", ka thënë ai. Zëvendësministri i Mbrojtjes ka folur edhe për tranzicionin e FSK-së, duke theksuar se çdo gjë është duke shkuar sipas planit. "Ky proces edhe do të vazhdojë, edhe do të përmbyllet suksesshëm, sepse themeli është i mirë, plani është i qartë, përkushtimi është stabil", është shprehur Ramadani

**"Epoka e re":** *Z. Ramadani, kemi parë që së fundi Serbia ka marrë disa mjete ushtarake nga Rusia si donacion. Çfarë do të thotë për sigurinë e rajonit?*

**Ramadani:** Serbia po dërgon mesazhe kërcënuese për tërë Ballkanin. Kjo që po shohim gjatë këtyre viteve të fundit është një ofensivë diplomatike e Serbisë për t'u armatosur me pajisje ruse të standardeve që nuk janë të ndërveprueshme as me NATO-n dhe as me vendet në rajon. Rrjedhimisht, kjo nënkupton se Serbia po e forcon ndërveprueshmërinë e vet ushtarake vetëm me Rusinë. Si e tillë, ky është orientim kundërshtues me tërë rajonin. Është vendim i regjimit autokratik të Serbisë që të mos bashkëpunojë me shtetet në rajon, sepse bashkëpunimi ndërlidhet drejtpërdrejt edhe me standardet e pajisjeve dhe sistemeve të armatimit. Sigurisht se ky është shqetësim serioz për tërë Ballkanin. E vetmja rrugë që e stabilizon sigurinë dhe paqen në Ballkan është modernizimi i shteteve ballkanike, sidomos në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Kur të gjitha shtetet e tjera në rajon ose janë anëtarësuar ose janë drejtuar qartësisht kah NATO-ja, është e vetmja Serbia që ka marrë rrugën e kundërt dhe për këtë rrugë të kundërt është duke u krekosur. Pra, ky orientim kah Rusia i Serbisë është diçka serioz për tërë Ballkanin.

**"Epoka e re":** *A mund të vlerësohet kjo si një kundërpërgjigje e Rusisë ndaj NATO-s, e cila synon që e gjithë rajonin ta integrojë në këtë organizatë?*

Ramadani: Zgjerimi i NATO-s në Ballkan nënkupton edhe zgjerim të demokracisë, qeverisjes demokratike dhe thellim të partneriteteve. Sigurisht se kjo kundërshtohet hapur dhe fuqishëm nga Rusia, e cila edhe më tutje po vazhdon hapat e kundërt me demokracinë. Përballja e Rusisë me NATO-n tashmë po thellohet në Ballkan përmes

# rcënuese për tërë Ballkanin



Serbisë. Duket krejtësisht qartë se presidenti autoritar i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, trashaluqi Ivica Daçiq dhe karikatura Aleksandar Vulin janë kthyer në ushtarë të Putinit në hakmarrjen ndaj NATO-s në Ballkan. Sigurisht se kjo paraqet shqetësim për të gjithë rajonin, sepse ishin po këta udhëheqës në Beograd që para 20 vjetësh i shërbenin Milloshevigit në veprimet shtetërore gjenocidiale kundër Kosovës dhe Bosnje e Hercegovinës.

**"Epoka e re":** *Cila duhet të jetë përgjigjja e vendeve të Ballkanit dhe aleatëve perëndimorë, në mënyrë që këto provokime të mos ndikojnë në sigurinë e rajonit?*
**Ramadani:** Shtetet pro perëndimore të Ballkanit duhet ta thellojnë përkushtimin ndaj demokracisë dhe bashkëpunimit rajonal. Nuk duhet të luhaten në asnjë formë në reformat demokratike të brendshme, bashkëpunimin biletaral dhe rajonal, modernizimin e institucioneve të sigurisë, sikurse edhe thellimin e partneritetit me ShBA-në, NATO-n dhe BE-në. Kjo është forma e vetme që mundëson stabilitet, siguri dhe paqe në Ballkan. Prania e ShBA-së, NATO-s dhe BE-së në rajonin tonë vazhdon të jetë çelësi i mirëmbajtjes së sigurisë dhe paqes. Lëkundjet në orientim properëndimor gjithnjë do të shkaktojnë vështirësi në rrugën përpara të rajonit. Prandaj, vendosmëria në zbatimin e vizionit properëndimor është rruga e vetme.

**"Epoka e re":** *Z. Ramadani, si po shkon zbatimi i tranzicionit të FSK-së?*
**Ramadani:** Tranzicioni i FSK-së është proces që ka filluar me hyrjen në fuqi të ligjeve të reja dhe, si i tillë, është në rrugë të sigurt. E kemi thënë vazhdimisht se tranzicioni është një proces dhjetëvjeçar, i cili është i koordinuar me partnerët strategjikë të Kosovës. Asgjë nuk ka qenë dhe nuk është e atypëratyshme. Të gjitha detajet e planifikuara mbesin udhërrëfyese për tranzicionin, zhvillimin dhe modernizimin e Forcës sonë. Ky proces edhe do të vazhdojë, edhe do të përmbyllet suksesshëm, sepse themeli është i mirë, plani është i qartë, përkushtimi është stabil.

**"Epoka e re":** *Lëvizja Vetëvendosje ka kritikuar qeverinë për këtë çështje duke thënë se ka ngecur plani i tranizicionit të FSK-së. Sa qëndrojnë këto kritika?*
**Ramadani:** Asnjëherë nuk është e tepërt ta shpreh mirënjohjen e sinqertë për të gjitha partitë politike që kanë mbështetur pa hezitim miratimin e ligjeve në Kuvendin e Kosovës, më 14 dhjetor 2018. Ne kemi pasur mbështetje të plotë dhe, si e tillë, kjo na ka lehtësuar punën në përmbylljen me sukses të përpjekjeve serioze për mandatimin ushtarak të FSK-së. Normalisht, shpresoj se ky unitet politik e qytetar për organizatën tonë ushtarake do të vazhdojë të ekzistojë gjithmonë. Edhe atëherë kur mund të ketë kritika, ato besoj se duhet të jenë të matura dhe me qëllim të përforcimit të ushtrisë sonë dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Në vendet demokratike, mbështetja për fushën e mbrojtjes dhe atë ushtarake është vazhdimisht përtej politikave ditore të subjekteve politike.

**"Epoka e re":** *Pas dorëheqjes së kryeministrit vendi pritet të shkojë në zgjedhje të parakohshme. A mund të kenë ndonjë ndikim zgjedhjet e reja në tranzicionin e FSK-së?*
**Ramadani:** Procesi i tranzicionit të FSK-së është afatgjatë. Edhe disa palë zgjedhje mund të ndodhin në ndërkohë, qoftë të parakohshme apo të rregullta. Prandaj, ky është një argument që e qartëson faktin që tranzicioni, zhvillimi dhe modernizimi i FSK-së, e ka rrugën e vet të ndarë nga proceset e tjera në Kosovë.

# Policia arreston gjashtë persona, pjesë e një grupi kriminal

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 31 KORRIK - Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve, nën masa të fshehta ka bërë hetimin e disa personave në regjione të ndryshme si në Prishtinë, Pejë, Prizren dhe Ferizaj. Pas aplikimit të masave të fshehta të hetimit, Policia e Kosovës ka arritur t'i arrestojë dymbëdhjetë persona në regjionet e lartcekura. Ndërsa vetëm më 30 korrik Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve DHTN - Pejë, në bashkëpunim me DHTN - Gjakovë, DHTN - Ferizaj, Njësinë e Reagimit të Shpejtë - Pejë, Forenzikën Rajonale - Pejë, Njësinë K9 si dhe një patrullë policore nga Stacioni Policor - Klinë, sipas urdhëresës së lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë, ka bërë arrestimin e gjashtë personave të dyshuar.

Personat e dyshuar të arrestuar janë: I. H. lindur më 1971 m/sh/k; I. P. lindur më 1976 m/sh/k; B. P. lindur më 1978 m/sh/k; A. R. lindur më 1976 m/sh/k; L. M. lindur më 1992 m/sh/k; dhe Xh. H. lindur më 1980 m/sh/k.

Lidhur me rastin, dëshmitë e konfiskuara si prova materiale nga personat e arrestuar janë: 2 900 euro, shtatë telefona, bllok xhepi me shënime, një veturë, gjashtë fletë tërheqje të parave, dy thika luftarake, një pistoletë e llojit TT me numër serik 05761 prodhim CZ llojit M-57 me dy karikator cal 7.6, dhjetë fishekë cal. 7. 62x25mm dhe dy fishekë me gaz cal. 9mm.

Pas intervistimit, në konsultim me prokurorin, 5 (pesë) të dyshuarve të parë u është shqiptuar masa e ndalimit policor prej 48 orësh, ndërsa i dyshuari i gjashtë është liruar në procedurë të rregullt.



# GLPS-ja: Kosova po ngec në implementimin e Ligjit për Ndihmë Shtetërore

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**Prishtinë, 31 korrik** - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka shprehur shqetësimin lidhur me mosimplementimin e Ligjit për Ndihmë Shtetërore, duke bërë thirrje për përdorim dhe alokim më efikas të parasë publike nga institucionet e Kosovës dhe duke promovuar kështu konkurrencën e drejtë si element kyç për funksionimin e mirëfilltë të tregut.

Edhe pse Ligji për Ndihmë Shtetërore ka hyrë në fuqi në fillim të vitit 2017, Departamenti për Ndihmë Shtetërore dhe Komisioni ende nuk kanë marrë masa adekuate hetimore kundrejt skemave ekzistuese në mënyrë që të bëhet një vlerësim nëse ndihmat shtetërore ekzistuese janë në harmoni të plotë me ligjin në fjalë. Sipas nenit 16 të këtij ligji, "komisioni propozon masa adekuate për të siguruar që çfarëdo skeme ekzistuese e ndihmës të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Sipas kësaj, komisioni mund ta kërkojë ndërprerjen e ndihmës ekzistuese dhe të vendosë për fillimin e hetimeve lidhur me ndihmë të kundërligjshme". "Për më tepër, neni 11 i Ligjit për Ndihmë Shtetërore parasheh që për të gjitha skemat e ndihmës shtetërore, dhënësi i ndihmës - institucionet e Kosovës - duhet ta njoftojnë Departamentin për Ndihmë Shtetërore lidhur me llojin dhe planin e ndihmës, në mënyrë që ky i fundit ta vlerësojë përputhshmërinë e ndihmës shtetërore me dispozitat e ligjit brenda afatit të caktuar. Kjo procedurë rregullohet hollësisht edhe me Rregulloren nr. 19/2018 për Procedurat dhe Format e Njoftimit për Ndihmën Shtetërore. Edhe pse procedurat e njoftimit për ndihmë shtetërore ekzistojnë, ato nuk janë përdorur ende nga institucionet e Kosovës, siç është edhe rasti i marrëveshjes së nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Contour Global për ndërtimin e Kosovës së Re, e cila përmban elemente në kundërshtim me Ligjin për Ndihmë Shtetërore si dhe me dispozitat e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit", është thënë në reagimin e GLPS-së.




Për më tepër, GLPS-ja ka vlerësuar se mosimplemetimi i Ligjit për Ndihmë Shtetërore dëmton rëndë edhe buxhetin e shtetit, marrë parasysh që mungesa e vlerësimit të rasteve ekzistuese dhe atyre aktuale, me theks të veçantë në rastet e dhënies së ndihmës së kundërligjshme, rezulton në mungesë të revokimit të kësaj ndihme. "Ligji për Ndihmë Shtetërore, neni 16, specifikon që ndihma e kundërligjshme duhet të kthehet së bashku me një normë të interesit të përcaktuar nga Komisioni për Ndihmë Shtetërore duke filluar nga dita kur është dhënë ndihma deri në datën e kthimit. Andaj, marrë parasysh mosimplementimin e Ligjit për Ndihmë Shtetërore, si dhe ndikimin që gjendja e tanishme mund të ketë në dëmtimin e konkurrencës së drejtë dhe funksionimin e tregut, GLPS-ja bën thirrje që institucionet relevante, Departamenti për Ndihmë Shtetërore dhe Komisioni, ta implementojnë Ligjin për Ndihmë Shtetërore, duke u fokusuar në rastet të cilat përmbajnë elemente në kundërshtim me ligjin në fjalë, si dhe në sektorët të cilët janë më të prirë ta dëmtojnë konkurrencën e drejtë në treg (i.e. telekomunikacioni, energjia si dhe, ndër të tjera, lehtësimet selektive nga taksat). Mosimplementimi i Ligjit për Ndihmë Shtetërore është theksuar si një problem kyç për funksionimin e mirëfilltë të tregu edhe nga raporti i fundit i Komisionit Evropian për Kosovën", është theksuar në reagimin e GLPS-së.

# Filloi punimet Seminari Mbarëkombëtar i Mësimit të Gjuhës Shqipe dhe Kulturës Shqiptare në Diasporë




EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

**Prishtinë, 31 korrik** - Në organizim të përbashkët të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë, ka filluar punimet Seminari i XV Mbarëkombëtar i Mësimit të Gjuhës Shqipe dhe Kulturës Shqiptare në Diasporë, i cili këtë vit po mbahet në Prizren.

Në këtë seminar tradicional po marrin pjesë përfaqësues të Ministrisë së Arsimit të Kosovës dhe të Shqipërisë, mësimdhënës që jetojnë dhe veprojnë në diasporë, të angazhuar në procesin e mësimit plotësues në gjuhën shqipe.

Fjalën e hapjes e mbajti zëvendësministri i Ministrisë së Arsimit të Kosovës, Heset Sahiti, i cili ka thënë se ky seminar tradicional është në funksion të këmbimit të përvojave më të mira të mësimdhënies për fëmijët në diasporë, ruajtjes së gjuhës, traditës e të kulturës sonë kombëtare.

Po ashtu, zëvendësministri Sahiti ka thënë se çdo ditë e më shumë po ndërmerren hapa konkretë për jetësimin e marrëveshjes së përbashkët në mes dy qeverive Kosovë - Shqipëri në fushën e arsimit, duke filluar nga kurrikulat e përbashkëta, tekstet shkollore për diasporën, programe dhe metodologji të reja të mësimdhënies moderne, për ta bërë sa më atraktiv të mësuarit e gjuhës shqipe.

Sahiti ka thënë se mësimi i gjuhës shqipe nga të rinjtë tanë në mërgim është i rëndësisë së veçantë për të gjithë ne sepse, veç të tjerash, mban lidhjet me vendlindjen dhe të gjitha trevat shqiptare. "Është detyrë dhe përgjegjësi e dy qeverive tona që të mbështesim këtë proces në vazhdimësi me të gjitha mundësitë që kemi", ka thënë ai.

Zëvendësministri Sahiti ka pohuar se MAShT-i e vlerëson punën dhe sakrificën e mësimdhënësve për angazhimin e palodhshëm në përmbushje të misionit prej mësimdhënësi kudo që jetojnë, për të mbajtur të gjallë gjuhën, kulturën dhe traditën tonë kombëtare.

Seminari do t'i vazhdojë punimet deri më 3 gusht.

# Ministri Tahiri kërkon nga autoritetet maqedonase që ta lirojnë ish-ushtarin UÇK-së, Tomor Morina

**Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, i ka shkruar letër homologes së vet të Maqedonisë së Veriut, Renata Deskoska, nga e cila ka kërkuar lirimin e ish-ushtarit të UÇK-së, Tomor Morinës, i cili është arrestuar nga policia maqedonase në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga "Interpol"-i, me kërkesë të Serbisë. Ai ka thënë se është bërë praktikë politike e pakuptimtë dhe tërësisht irracionale përndjekja që Serbia vazhdon t'ua bëjë qytetarëve të Kosovës përmes fletarrestimeve ndërkombëtare, baza e të cilave derivon kryesisht nga regjimi famëkeq i Milloshevicit**



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 31 KORRIK - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, i është drejtuar me letër ministres së Drejtësisë të Maqedonisë së Veriut, Renata Deskoska, nga e cila ka kërkuar lirimin e Tomor Morinës, i cili është arrestuar nga policia maqedonase në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga "Interpol"-i, me kërkesë të Serbisë.
Përmes kësaj deklarate për media, ministri Tahiri ka bërë me dije se ka kërkuar shqyrtimin e aspekteve ligjore dhe rrethanave të tjera për lirimin e Morinës, i cili është arrestuar në territorin e Maqedonisë së Veriut më 24 korrik sipas urdhërarrestit ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet e Serbisë. "Sot i kam drejtuar një letër homologes sime në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Renata Deskoskes, përmes së cilës kam kërkuar lirimin e qytetarit Tomor Morina, i cili është duke u mbajtur në arrest mbi bazën e një urdhërarrestimi ndërkombëtar të lëshuar nga Serbia. Është bërë praktikë politike e pakuptimtë dhe tërësisht irracionale përndjekja që Serbia vazhdon t'ua bëjë qytetarëve tanë përmes fletarrestimeve ndërkombëtare, baza e të cilave derivon kryesisht nga regjimi famëkeq i Milloshevicit", ka bërë me dije Tahiri.
Ai ka shtuar se "për më tepër, irracionaliteti i këtyre kërkesave, duke u bazuar në juridiksionin inekzistent të saj mbi Kosovën sikur të ekzistonin dy botë paralele, përderisa Republika e Kosovës është shtet sovran dhe askush s'ka juridiksion mbi të e shtetasit e saj, po e shpërfaq jo vetëm këtë praktikë, por edhe logjikën e pushtetit të Beogradit si logjikë e përndjekjes së shtetasve tanë për qëllime politike dhe aspak për çështje që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit".
Ministri Tahiri ka thënë se rruga e një shteti që aspiron BE-në e që praktikon një doktrinë përndjekëse ndaj qytetarëve të lirë të një vendi fqinje është rrugë që shpie në qorrsokak. "Kjo praktikë duhet të marrë fund njëherë e përgjithmonë dhe është tepër e nevojshme që në këtë drejtim Bashkimi Evropian ta ushtrojë presionin mbi Serbinë. Republika e Kosovës nuk do të rrijë indiferente ndaj kësaj çështje, as sot, as në të ardhmen, deri kur një praktikë e tillë të marrë fund", ka thënë ministri Tahiri.
Serbia e ka paraqitur pranë autoriteteve të Maqedonisë së Veriut kërkesën për ekstradimin e ish-pjesëtarit të UÇK-së, Tomor Morina. Detaje të tjera mbi kërkesën e palës serbe nuk jepen, ndërkohë që lidhur me këtë kërkesë duhet të vendosë Ministria e Drejtësisë në Shkup.

## Gjakova proteston për ish-ushtarin e UÇK-së, kërkohet lirimi i tij

Në Gjakovë të mërkurën është mbajtur një protestë, ku është kërkuar lirimi i ish-luftëtarit të UÇK-së, Tomor Morina. Familjarë e qytetarë të shumtë kanë kërkuar që institucionet e Kosovës të punojnë me shumë që Maqedonia e Veriut ta lirojë sa më shpejt Morinën.
Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka bërë me dije se kryeministri në dorëheqje Ramush Haradinaj e ka njoftuar se ka pasur biseda me autoritetet maqedonase dhe i është premtuar se do të jenë të kujdesshëm sa i përket këtij rasti.
Në emër të familjes së Tomor Morinës, ka folur Gurakuq Dobruna, i cili ka deklaruar se janë më shumë të brengosur sot për Tomorin sesa kur kishte qenë në luftë. Kurse kryetari i OVLUÇK-së në Gjakovë, Sadri Hoxha, i ka bërë apel Ministrisë së Punëve të Jashtme që të merret me këtë rast, në mënyrë që sa më shpejt Tomor Morina t'i kthehet familjes.

# Gazetari Nuhi Bytyçi intervistohet nga Gjykata Speciale

PRISHTINË, 31 KORRIK (ER) - Gazetari Nuhi Bytyqi është intervistuar nga prokurorët speciale të Gjykatës Speciale lidhur me veprimtarinë e tij si gazetar gjatë luftës. Ai nëpërmjet një deklarate për media ka thënë se të gjitha përgjigjet e tij në interesimin e prokurorisë ishin në shërbim të së vërtetës së luftës çlirimtare të UÇK-së, të argumentimit të sakrificës së luftëtarëve të lirisë dhe mbështetjes së popullatës civile dhënë UÇK-së. "Pas kërkesës zyrtare me shkrim, që më është dërguar nga Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës, kam dhënë dëshminë lidhur me veprimtarinë time si gazetar gjatë periudhës së luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dua ta njoftoj opinionin publik se e gjithë dëshmia ime, të gjitha përgjigjet e mia në interesimin e prokurorisë, ishin në shërbim të së vërtetës së luftës çlirimtare të UÇK-së, të argumentimit të sakrificës së luftëtarëve të lirisë dhe mbështetjes së popullatës civile dhënë UÇK-së. Puna ime si gazetar dhe si udhëheqës i ekipit televiziv të Televizionit Shqiptar në zonat e luftës, e prezantuar në TVSh dhe në mediat botërore përmes shumë emisioneve televizive, është dëshmia më e mirë e angazhimit tonë të pastër, e orientimit të drejtë dhe fisnik të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", ka thënë Bytyqi në deklaratën e tij për media.



Ai ka theksuar se bazuar në këtë angazhim profesional dhe kombëtar në shërbim të lirisë së atdheut të tij, e kishte të lehtë që edhe para Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës ta dëshmojë të vërtetën në mbrojtje të veprimtarisë çlirimtare. "Ashtu siç e kam thënë edhe në deklarimet e mia të mëhershme, unë jam krenar që kam qenë pjesë aktive e luftës çlirimtare të viteve 1998-1999 dhe jam i gatshëm që në çdo kohë të dëshmoj të vërtetën e sakrificës gjithëpopullore për liri dhe pavarësi. Lufta çlirimtare e viteve 1998 dhe 1999 simbolizon sakrificën sublime dhe mbijetesën e popullit të Kosovës dhe është lufta vendimtare që bëri të mundur çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës", ka thënë Nuhi Bytyçi, gazetar.

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ndan mirënjohjet e partneritetit ShBA - Kosovë

# Ambasadori i ShBA-së: Ekonomia e

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Philip S. Kosnett, ka thënë se qeveria amerikane është e përkushtuar t'i mbështesë jo vetëm bizneset amerikane, por edhe popullin në Kosovë, komunitetin e biznesit, si dhe qeverinë për të ndërtuar prosperitet në vend. Ai ka theksuar se ekonomia e Kosovës duhet të rritet 8 për qind në vit për 30 vjetët e ardhshëm. Sipas ambasadorit amerikan, qeveritë në Kosovë duhet të jenë më serioze në mbështetjen e sektorit privat




# ARKEP-i po analizon situatën e krijuar pas shkëputjes së kontratës së Telekomit me 'Z-Mobile'




**Prishtinë, 31 korrik (ER)** - Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) ka reaguar në lidhje me procesin e shkëputjes së kontratës ndërmjet operatorit Telekomi i Kosovës dhe operatorit Dardafon.net "Z-Mobile". Përmes një komunikate për media, ARKEP-i ka theksuar se marrëdhëniet ndërmjet operatorëve të rrjetit dhe operatorëve virtualë aktualisht në Kosovë janë të lejuara me marrëveshje komerciale. "Në njoftimin e vet, Telekomi i Kosovës është zotuar se në pajtim me kushtet kontraktuale komerciale do të aplikojë një periudhë transitore në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve për mosndërprerje të shërbimit. ARKEP-i është duke analizuar situatën e krijuar dhe në pajtueshmëri me kornizën ligjore dhe rregullative në fuqi do të ndërmarrë veprime rregullative nëse një gjë e tillë është e nevojshme në ditët në vijim, pas sqarimeve të pranuara nga palët në proces", është thënë në komunikatën e ARKEP-it.

Po ashtu, ARKEP-i ka vlerësuar se në bazë të ligjit për komunikimet elektronike, ky institucion në punën dhe në marrjen e vendimeve të veta është i pavarur nga çdo palë tjetër. "Ne do t'i ndërmarrim të gjithë hapat e duhur ligjorë me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës", është thënë në këtë komunikatë.

Një ditë më parë Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) ka theksuar se sa më parë të ndërmerren veprimet që 300 000 numrat në përdorim të "Z-Mobile"-s t'i kalojnë Valës ashtu edhe siç i takojnë.

Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, ka bërë me dije se për konsumatorët që shfrytëzojnë shërbimet e "Z-Mobile" nuk do të paraqitet asnjë problem. "Të gjithë konsumatorët që shfrytëzojnë shërbimet e Dardafon (Z-Mobile) të mos bien në panik, sepse në bashkëpunim në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Kosovës (ARKEP) jemi duke punuar ngushtë që ta zbatojmë edhe fazën e tranzicionit që do të zgjasë nga 30 deri 120 ditë", ka thënë Istrefi.

# Kosovës duhet të rritet 8 për qind




EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 31 KORRIK - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka ndarë mirënjohjet e partneritetit ShBA - Kosovë si vlerësim për kompanitë që në mënyrë aktive kanë kontribuar për fuqizimin e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kosovës.

Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip S. Kosnett, ka thënë se një ndër detyrat e cilitdo ambasador amerikan është t'i ndihmojë bizneset amerikane që të zgjerohen anembanë globit dhe kjo është kruciale për ShBA-në pasi krijon vende të punës dhe prosperitet në shtëpi, ofron produkte cilësore në treg si dhe siguron rritje të qëndrueshme.

Ambasadori Kosnett ka theksuar se qeveria amerikane është e përkushtuar t'i mbështesë jo vetëm bizneset amerikane, por edhe popullin në Kosovë, komunitetin e biznesit, si dhe qeverinë për të ndërtuar prosperitet në vend. "Për momentin, rritja sillet rreth 4 për qind. Kjo mund të tingëllojë mbresëlënëse, mirëpo Kosova prodhon për kokë banori vetëm rreth një të dhjetën e mesatares së Evropës. Kjo do të thotë se për ta arritur trendin e rritjes në Evropë, ekonomia e Kosovës duhet të rritet 8 për qind në vit për 30 vjetët e ardhshëm. Kosovës i nevojitet një ekspansion i sektorit privat për të realizuar këtë synim, ndërsa qeveria duhet të jetë më serioze në mbështetjen e sektorit privat. Është e rëndësishme që, pavarësisht formës së qeverisë së ardhshme, ajo duhet të jetë e përkushtuar për veprime konkrete për rritjen e fleksibilitetit dhe konkurrueshmërisë së sektorit privat të Kosovës. Që bizneset të mund të mbijetojnë, qeveria duhet ta zvogëlojë korrupsionin dhe t'i promovojë standardet profesionale në qeveri, biznes dhe edukim", ka thënë Kosnett.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka vlerësuar pozitivisht për Kosovën rritjen e pranisë së brendeve dhe kompanive amerikane në Kosovë, për të cilën Oda Amerikane angazhohet në vazhdimësi. "Jemi mbledhur për t'u dhënë mirënjohje kompanive anëtare të Odës Amerikane, të cilat kanë kontribuar për fuqizimin e marrëdhënieve ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës si dhe për kontributin e tyre për rritjen ekonomike të vendit, transferimin e teknologjisë, krijimin e vendeve të punës dhe për ofrimin e shpresës për njerëzit e këtij vendi", ka thënë Zeka.

Presidenti i Bordit të Guvernatorëve të Odës Amerikane, Ilir Ibrahimi, ka theksuar se Kosova dhe ShBA-ja kanë marrëdhënie në fusha të ndryshme, mirëpo marrëdhëniet ekonomike janë më të mirat dhe më të fuqishmet. Prandaj, Ibrahimi ka shtuar se misioni i Odës Amerikane për këtë vit dhe vitet e tjera mbetet fuqizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe ShBA-së dhe bizneset janë ato të cilat e bëjnë këtë të mundur. Mirënjohjet e partneritetit ShBA - Kosovë janë ndarë për importuesit më të mëdhenj të produkteve me origjinë të ShBA-së.

## Parku i Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren së shpejti do të jetë në shërbim të të rinjve inovatorë

PRISHTINË, 31 KORRIK (ER) - Ministri në detyrë i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Muzafer Shala, ka vizituar të mërkurën Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren, ku është njoftuar për së afërmi me punën që është duke u bërë rreth transferimit të tij, nga një bazë ushtarake në një hapësirë për inovatorët dhe ndërmarrësit e rinj.

Shala ka bërë me dije se shumë shpejt Parku i Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren, pas transformimit, do të jetë i gatshëm. "Kampi është duke kaluar në një periudhë tranzicioni nga bazë ushtarake në hapësirë për të rinjtë dhe shumë shpejt do ta kemi në funksion të plotë për ta", u shpreh ai.

Ministri në detyrë i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Muzafer Shala, ka thënë se shumë shpejt kjo qendër do të jetë gati për të rinjtë në tri fusha kryesore. "Kënaqësi teksa sheh plot 23 hapësira punuese me 36 hektarë dhe vend akomodimi për 1 600 persona. Kjo qendër do të jetë në shërbim të të rinjve inovatorë në tri fusha kryesore si IT, Agro Industri dhe Ndërmarrësi", ka deklaruar Shala.

Ai ka thënë se Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë do të angazhohet që hapësirat në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren t'u jepen në shfrytëzim kompanive të mëdha të cilat janë të interesuara të investojnë në Kosovë.



## AKP-ja miraton listën e aseteve të shitjes me likuidim SHAL 50 dhe transaksionet e SHAL 48

PRISHTINË, 31 KORRIK (ER) - Bordi i drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) ka mbajtur mbledhjen e rregullt në të cilën ka marrë vendime të rëndësishme për procesin e privatizimit dhe të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore në përputhje me mandatin e vet ligjor.

Në këtë mbledhje bordi i drejtorëve vendosi për miratim të listës së aseteve të paraqitura për shitje në SHAL 50 dhe miratoi transaksionet e SHAL 48. Veç kësaj, bordi i drejtorëve i AKP-së ka shqyrtuar raportet rekomanduese të Njësisë së Negocimit Direkt si dhe raportet përfundimtare të po të njëjtës njësi. "Bordi diskutoi edhe në lidhje me propozimin për largim të subjekteve juridike Ndërmarrjet/Subjektet juridike, Kosovatransat, nga autoriteti administrativ dhe kompetencat e AKP-së të cilin e miratoi. Pas



shqyrtimit BORDI miratoi edhe propozimin e Autoritetit të Likuidimit për N. Sh. 'Agrokultura' lidhur me aprovimin e qiradhënies direkte për kompaninë 'SOwI Kosovo' si dhe propozimet e tjera nga autoritetet e likuidimit lidhur me qiradhënie të aseteve", është thënë në njoftimin e AKP-së.

Mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve të AKP-së është caktuar më 30 gusht.

## Haskuka: Bashkëpunimi me qytetarë dhe transparenca, shtyllat kryesore të qeverisjes sonë

Prizren, 31 korrik (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka mbajtur një takim me qytetarë, në të cilin ka prezantuar punën gjashtëmujore të komunës për këtë vit. Gjatë prezantimit kryetari Haskuka ka njoftuar për angazhimin e deritashëm në aspektin e shërbimeve efikase, regjenerimit urban, arsimit cilësor, zhvillimit të bujqësisë, trashëgimisë kulturore, turizmit, zhvillimit ekonomik dhe shëndetësisë, duke i përmendur disa prej projekteve kryesore që janë realizuar apo janë në realizim e sipër. Ai ka theksuar se bashkëpunimi me qytetarët dhe transparenca janë shtyllat kryesore të qeverisjes së tij në Prizren.
Pas prezantimit u mbajt edhe një diskutim me qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare e të bashkësive lokale që ishin të pranishme, me ç'rast u pranuan pyetjet dhe kërkesat e tyre.
Raporti gjashtëmujor i komunës dhe të gjitha raportet gjashtëmujore të drejtorive janë të publikuara në uebfaqen zyrtare të Komunës së Prizrenit.



# ‘Ramë Lahaj and Friends’ sot mbajnë koncert në kryeqytet

Prishtinë, 31 korrik (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, bashkë me tenorin Ramë Lahaj, baritonin Kiril Manolov, dirigjentin David Crescenzi dhe drejtoreshën për Kulturë, Blerta Basholli, kanë prezantuar në një konferencë për media detajet e koncertit që do të mbahet sot (e premte) në mbrëmje në orën 20:30 në Sheshin "Skënderbeu".
"Pas një koncerti të suksesshëm që e organizuam bashkë me Filarmoninë e Kosovës në kuadër të aktiviteteve 20/20, kemi vendosur që gjatë këtyre 'Ditëve të diasporës', kur kemi shumë vizitorë, publikut të Prishtinës dhe Kosovës t'i ofrojmë edhe një ngjarje fantastike, me këtë rast me tenorin tonë të mirënjohur Ramë Lahaj. Rama me miq do të performojë në Sheshin 'Skënderbeu' dhe koncerti është pa bileta dhe hyrja është falas. Pres që mbrëmja e nesërme të na mbetet gjatë në kujtim", ka thënë Ahmeti.
Ndërsa Ramë Lahaj ka thënë se ka qenë në Prishtinë vitin e kaluar në koncertin e Apostolovës dhe e ka parë që Prishtinës ia ka borxh një koncert të madh. "Edhe mua më është plotësuar dëshira sepse e kam ndjerë si borxh. Jam jashtëzakonisht i nderuar që arritëm të organizojmë këtë koncert me mbështetjen e kryetarit Ahmeti dhe që kam pasur mundësi të vijë në Prishtinë bashkë me kolegët", ka thënë Ramë Lahaj.




# Më 2 gusht hapet Panairi i Librit në Ferizaj



Ferizaj, 31 korrik (ER) - Dashamirët e librit kanë mundësinë që ditët e para të muajit gusht t'i kalojnë pranë stendave të librave që do të vendosen nga 2 deri më 4 gusht në sheshin qendror të Ferizajt, në hapjen e Panairit të Librit që mëton të jetë i përvitshëm.
Tashmë shtëpitë botuese, bashkë me ta edhe drejtuesit e Klubit Letrar "De Rada" në Ferizaj, organizatorë të kësaj ngjarje, kanë bërë gati të gjitha përgatitjet.
Verës po i shtohet edhe kjo ngjarje e rrallë e këtij lloji dhe përmase në qytetin tonë. Ulje çmimesh për libra të llojllojshëm, tituj të rinj, botime nga më të ndryshmet e aktivitete përcjellëse artistike janë disa prej aktiviteteve që do të shënojnë këtë ngjarje që ngre siparin në ditën e dytë të gushtit.
Organizatorët e Klubit Letrar "De Rada", të mbështetur edhe nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe nga Komuna e Ferizajt, thonë se janë gati të mirëpresin qindra e mijëra vizitorë ferizajas e nga qendra të tjera, sidomos të rinj, që kultura e leximit dhe qarkullimi i librit ta ngrehë standardin.
Ferizaj, qendra nga ku burojnë ide dhe nisma kulturore të vlefshme, edhe kësaj radhe po jep shembullin se si me djersë dhe përpjekje të pandalshme qytetarëve iu ofrohen ngjarje dhe çaste të veçanta kulturore-artistike. Me kosto minimale qytetarët kanë një mundësi më shumë ta pasurojnë jetën e tyre intelektuale dhe sociale, duke vizituar e blerë librat që zënë vend në këtë panair.

## Ka filluar meremetimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Kijevë

Malishevë, 31 korrik (ER) - Falë një donacioni nga organizata zvicerane AQH, këto ditë ka filluar meremetimi i objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Kijevë. Meremetimin e kësaj QMF-je e kanë parë nga afër kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori komunal për shëndetësi, Liridon Hoti, të cilët edhe janë njoftuar nga afër me të gjitha punimet që janë duke u bërë. "Këtu është duke u bërë një punë e mirë, pasi është duke u bërë meremetimi, pothuajse i tërësishëm i objektit, si dhe është duke u vendosur edhe ngrohja në mënyrë që qytetarët të kenë shërbime më të mira shëndetësore", ka thënë Begaj, i cili ka kërkuar nga punëkryesi që të mos ketë vonesa për realizimin e projektit. Begaj dhe drejtori Hoti edhe një herë e kanë falënderuar organizatën zvicerane AQH për këtë donacion me rëndësi. Shërbimet shëndetësore që janë ofruar në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Kijevë përkohësisht janë bartur në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Llazicë deri në përfundimin e meremetimit të tërësishëm të objektit.



Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (8)

# ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

## - Përshtypjet në "librin e zisë"



Përgatiti: Selatin NOVOSELLA

Unë Miftar Miftari nga Baksi i Skenderajt kam ardhur për të nderuar Bacë!
Po të më pyeste një gazetar për figurën e Bacës Adem se si ishte për kombin për kombin dhe atdheun, do të përgjigjesha: Çdo fjali e Tij ishte enciklopedi për atë se si krijohet, jeton e zhvillohet kombi shqiptar dhe se si krijon sigurinë për të jetuar. Do jetosh sa të jetë Bota!

27 korrik 2018,
Miftar Miftari, Baks

Dragi prijatelju!
Otišao si na onaj svijet, ali za meni nijesi mrtav i nijesi umro...Osta?eš vje?no da -iviš i siješ kao ju?e, oduvjek!
Blago tome ko dovjek -ivi imao i zašto raditi!
Tvoj prijatelj sa dubokim poštovanjem i s'ljubavlju!
Neka ti je vje?na slava, i hvala na svemu!

27 Juli 2018,
S. Kji?i?

Lavdi jetës dhe veprës atdhetare të Bacës Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
SH. H Feniks, Ferizaj

Baca Adem Demaçi, i lehtë të qoftë dheu i Shqipërisë!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem Demaçi, Nderi i Shqipërisë!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem Demaçi ishte rreze e lirisë, pishtar i njerëzimit, krenari e kombit!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Lavdi veprës kombëtare dhe intelektuale të simbolit tonë të Lirisë, Adem Demaçit!

27 korrik 2018,
Prof. Dr. Shyqri Galica

Lumë Atdheu që të rriti! Fjala dhe vepra juaj do t'i shërbej jo vetëm kombit shqiptar por edhe gjithë njerëzimit. Ishe dhe mbete inspirim i formimit atdhetar për shumë shqiptar, por edhe humanist i pashoq!

27 korrik 2018,
Dibran Fylli

Baca, Adem, ke bërë aq shumë, e aq pak të dukej dhe doje të beje shumë më tepër për Kosovën! Krenar do jemi përgjithmonë me Ty!

27 korrik 2018,
Shkëndije Azemi

Baca Adem,
Burrat e Kombit si Ju, kurrë s'vdesin. Ti mbetesh frymëzim i brezave!

27 korrik 2018,
Sanije Bajra - Topalli

Adem Demaç, njëherë ka lindë nëna Kosovë dhe nëna Shqipëri!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

O vëllai im, ta pata lakmi këtë botë! Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës! E paq edhe Botën tjetër!

27 korrik 2018,
Qerime Hakaj, Drenicë

Ngushëllimet na duhen neve se humbëm një pejgamber, një njeri të shenjtë, që kurrë nuk ia ditëm vlerën, ndërsa lavdia dhe krenari i takon Familjes se më të shenjtit njeri tonë zotëri Adem Demaçit!

27 korrik 2018,
Mirëdon Hoxha

Ideatori, strategu, frymëzuesi i rezistencës dhe i lëvizjes kombëtare çlirimtare e demokratike! I pavdekshëm mbetesh Baca Adem!

27 korrik 2018,
Ylli Kaloshi

Ngushëllimet më të sinqerta familjes dhe gjithë shqiptarëve! Bacë, faleminderit përjetë për krejt çfarë bëre dhe ofrove për ne! Prehu në paqe!

Lavdi e përbotshme!

27 korrik 2018,
Ejup Brajshori

Yll i pashuar i demokracisë, diell që ngrohë jo vetëm Kosovën, por edhe botën Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Milaim Lumi

I lutem Zotit të të shpërblejë me xhenet, legjendë e gjallë e kombit shqiptar Baca Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Albion e Milaim Rushiti

Lavdi jetës dhe veprës së Bacës Adem Demaçi, NDERI I KOMBIT!

27 korrik 2018,
Naim Sadiku

Lavdi e përjetshme jetës dhe veprës së Heroit tonë kombëtar dhe Nderit të Kombit, Bacës Adem!

27 korrik 2018,
Fadile Sadiku

Krenohemi të gjithë shqiptarët, që të patëm, o Baca Adem Demaçi!
Lavdi jetës dhe veprës Tënde!

27 korrik 2018,
Sinan Ismajli, Likoshan, Drenas

Ti nuk ke vdekur! Jeni përherë i gjallë në zemrat tona! Lavdi Bacës Adem!

27 korrik 2018,
Nexhi e Sebi Zeqiri

Erdhëm Bacë! Shoqëria Lëvizje erdhi për t'u ndarë me dhembje për Ty, Bacë! Gjithmonë krenar dhe faqebardhë me Ty që na mësove e na frymëzove e na edukove të jetojmë, të veprojmë e të vdesim si shqiptar të Shqipërisë... Të qoftë i lehtë i lehtë dheu i tokës arbërore!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Fjalët janë të pakta dhe me shkrim nuk mund i përshkruajmë gjithë veprimtarinë Tuaj - Bacë! Jemi krenar që të kishim! Lavdi veprës Sate!

27 korrik 2018,
Florim Berisha, Preshevë

Baca Adem, i lehtë të qoftë dheu i Kosovës. Ti ishe frymëzues i këtij kombi, andaj gjithmonë do të jesh udhërrëfyes i imi dhe i mbarë kombit!

27 korrik 2018,
Fehmi (mbiemri i palexueshëm)



Adem Demaçi ishte shqiptar i vërtetë dhe shembull për të tjerët dhe për rininë e Kosovës REPUBLIKË! Lavdi të qoftë, Bacë!

27 korrik 2018,
Me respekt, Zef Prek Prenaj

Baca Adem, çlirimtari e atdhetari, që frymëzove brezin Tënd e tonin. Më fal nëse veprën tënde nuk e bëmë sa duhet publike... Jam i bindur se vepra juaj do depërtojë e jetoj tek çdo familje shqiptare në vazhdim!

27 korrik 2018,
A. Boja

Baca Adem, jam krenar që të takova në burgun e Gradishkës. Krenohem për Ty që luftove e jetove për gjithë Shqipërinë! Lavdi!

27 korrik 2018,
Asllan Rushiti



Kur nuk kishin shkolla shqiptarët, Adem Demaçi ishte mësues, kur nuk kishin universitet ishte intelektuali i tyre, e kur nuk kishin ushtri ai ishte luftëtari.
Ështe tallur me vdekjen dhe i ka buzëqeshur rrezikut. I qëndrueshëm përtej imagjinatës dhe frymëzues jashtë vetëdijes. Me kthjelltësi në mendje, me këngë në zemër, me kurriz në trup dhe me fjalët në majë të gjuhës. Bindjet nuk ia ndryshoi as koha e as mosha.
Adem Demaçi ka jetuar gjatë dhe shumë, i tillë do të jetë edhe ndikimi i tij: i gjatë në ardhmëri dhe i shumtë ndër brezat që do të vijnë.
Përkulemi para jetës dhe veprës së Bacë Adem Demaçit!
Lavdi!
Albin Kurti
27 korrik 2018

*Faksimil i përshtypjes të Albin Kurtit, Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje*

I lehtë të qoftë dheu i Mëmëdheut, Bacë, Adem Demaçi! Ishe, je dhe do mbetesh ideali i rinisë Shqiptare! Lavdi të qoftë!

27 korrik 2018,
Ilmi Kiçmari

Lavdi të qoftë përjetë, Bacë Adem Demaçi, frymëzimi i rinisë sonë!

27 korrik 2018,
Alban Abdullahu

Ngushëllimet më të sinqerta për Bacën Adem! Jeta dhe vepra Juaj ishte frymëzim për brezat që sakrifikuan dhe për ne që e gëzojmë lirinë e Kosovës!
Lavdi e përjetshme!

27 korrik 2018,
J. Imeri, ATK

Ngushëllimet e mia nga zemra për njeriun më të madh të rezistencës së Kosovës! Lavdi e përjetshme Bacë Ademit!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Ngushëllime për Zemrën e Kombit Shqiptar, Adem Demaçin! Prehu në paqe!

27 korrik 2018,
Florije (mbiemri i palexueshëm)

Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës! Nderi i Kombit, Baca Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Elife Podvorica

Bacë, të qoftë i lehtë dheu i Kosovës, që aq shumë e deshe!

27 korrik 2018,
Fatime Shala Ismaili

Baca Adem, lum populli që të ka! Lavdi

27 korrik 2018,
Safete Kryeziu Shala

Ishe vëllai i vetëm i babait tim! Si familje ju bëjmë hallall të gjitha ndejat në shtëpinë tonë! Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës që aq shumë e deshe!

27 korrik 2018,
Avni Jashari, me familje

Kërkoje të vdisje përditë për atdhe! Nuk do të vdesësh kurrë, shoku i idealit!

27 korrik 2018,
Kadri (mbiemri i palexueshëm)

Mburremi si popull me Hasan Prishtinën, Adem Jasharin dhe Adem Demaçin, për jetë të jetëve!

27 korrik 2018,
Zeqir Bekolli

**(Vazhdon në numrin e ardhshëm)**

## Sekretari Pompeo fillon turneun në Azinë Juglindore



UASHINGTON, 31 KORRIK - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, këtë javë shkon në Azinë Juglindore, Australi dhe Mikronezi dhe nuk ka përjashtuar mundësinë e bisedimeve me zyrtarë të Koresë së Veriut gjatë takimit rajonal të vendeve të ASEAN-it në Tajlandë. Tensionet me Kinën gjithashtu mund të jetë ndër temat kryesore të takimit të ASEAN-it.
Tajlanda është ndalesa e parë e diplomatit më të lartë amerikan ku ai do të kryesojë një takim mes Shteteve të Bashkuara dhe vendeve të ASEAN-it sot (e enjte) dhe ku do të diskutohet mbi vizionin e përbashkët të një Indo-Paqësori të lirë dhe të hapur. Por pyetjet rreth bisedimeve të mundshme me Korenë e Veriut po e shoqërojnë Pompeon kudo që ai shkon. "Do të jem në Bangkok për dy ditë. Shpresojmë se diskutimet në nivel pune do të fillojnë shumë shpejt", tha ai.
Duke folur për "Zërin e Amerikës", zëdhënësja e Departamentit të Shtetit, Morgan Ortagus, tha se ajo nuk mund ta përjashtonte mundësinë e bisedimeve me zyrtarët e Koresë së Veriut gjatë këtij turneu. "Negociatat tona me Korenë e Veriut janë disa nga gjërat më të ndjeshme që duhet t'i bëjmë kudo në botë. Pra, ne do të vazhdojmë të bisedojmë me aleatët tanë që po përballen nga afër me këto çështje, pra pavarësisht nëse bëhet fjalë për Korenë e Veriut, Kinën apo një mori çështjesh të tjera në Azinë Juglindore", tha ajo.
Ortagus tha se Deti i Kinës së Jugut është një çështje tjetër shqetësuese, ku Kina ka marrë nën kontroll zona të mëdha në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar.

# Politika e jashtme në fokus të debatit në mes të kandidatëve demokratë për president

Në debatin e parë mes demokratëve, i cili do të pasohet nga një debat tjetër, ku do të paraqiten 10 kandidatët e tjerë që synojnë nominimin e Partisë Demokratike për garën presidenciale të ShBA-së më 2020, në qendër të vëmendjes ishin shëndetësia, migracioni dhe politika e jashtme



UASHINGTON, 31 KORRIK - Dhjetë kandidatët presidencialë demokratë janë përplasur me argumente në një debat televiziv në Shtetet e Bashkuara.
Ky është debati i parë në mes të demokratëve i cili do të pasohet nga një debat tjetër ku do të paraqiten 10 kandidatët e tjerë, përfshirë Joe Biden dhe Kamala Harris, që synojnë nominimin e Partisë Demokratike për garën presidenciale të ShBA-së më 2020.
Shëndetësia, migracioni dhe politika e jashtme dominuan në debatin që u zhvillua të martën në mbrëmje.
Elizabeth Warren dhe Bernie Sanders, ndër kandidatët më të njohur mes demokratëve, ishin në qendër të kritikave nga kundërkandidatët e tyre.
Ashtu si presidenti i ShBA-së, Donald Trump, senatori Bernie Sanders shprehu neverinë e tij ndaj rolit "polic i botës" nga ana e ShBA-së. Sandersi tha se ai do ta përmirësonte qëndrimin e ShBA-së me Kombet e Bashkuara dhe do të përqendrohej në diplomaci në vend të veprimeve ushtarake. "Ajo që na duhet është një politikë e jashtme që përqendrohet në diplomaci dhe përfundimin e konflikteve nga njerëzit që ulen në tryezë dhe diskutojnë", tha Sanders.
Kryebashkiaku i Indianës, Pete Buttigieg, një ish-oficer i inteligjencës në Rezervat e Marinës, tha se ai do t'i tërheqë trupat nga Afganistani në vitin e tij të parë në detyrë. "Mendova se isha një nga trupat e fundit që po largohej nga Afganistani", tha Buttigieg për luftën 18-vjeçare në atë vend.
Ish-kongresisti Beto O'Rourke u zotua t'i përfundojë pranitë e huaja në Irak, Jemen, Somali, Libi dhe Siri. Ai gjithashtu premtoi t'i tërhiqte trupat nga Afganistani në mandatin e tij të parë. "Si president, unë do t'i përfundoj ato luftëra dhe nuk do të fillojmë luftëra të reja, ne nuk do të dërgojmë më shumë anëtarë të shërbimit amerikan jashtë shtetit për ta sakrifikuar jetën e tyre dhe për ta marrë jetën e të tjerëve në emrin tonë", tha ai.
Si Sanders, O'Rourke tha që ShBA-ja duhet të përqendrohet më shumë në diplomacinë paqësore. Sa i përket kërcënimit të paraqitur nga Koreja e Veriut dhe udhëheqësi i saj Kim Jong Un, kandidati nga Ohio, Tim Ryan, tha se nuk mendoj se presidentët e ShBA-së duhet të takohen me diktatorët.
Senatorja Amy Klobuchar nga Minesota foli ndryshe, duke thënë se ajo beson se duhet të jetë gjithmonë e hapur për t'u takuar me "këdo në çdo vend". "Unë besoj se ju takoheni me njerëz, por kur keni një agjendë dhe vendosni interesat e vendit në rend të parë", tha Klobuchar.
Ne debat kishte përplasje, nëse ShBA-ja duhet t'i përdorë armët bërthamore si masë mbrojtëse. Guvernatori i Montanas, Steve Bullock, tha se ai "nuk do ta largonte këtë opsion nga tryeza".
Senatorja e Masaçusets, Elizabeth Warren, tha se ShBA-ja duhet të përdorë armë bërthamore vetëm nëse një vend tjetër e përdor atë së pari. "Përgjegjësia jonë është ta ruajmë sigurinë tonë", tha Warreni.

## Presidentja kroate i demanton deklaratat e pretenduara për Bosnjën



ZAGREB, 31 KORRIK - Presidentja e Kroacisë, Kolinda Grabar Kitaroviq, mohoi se ka deklaruar se Bosnjë e Hercegovina është shtet i paqëndrueshëm nën kontrollin e islamit militant.
Gazeta izraelite "Jerusalem Post" ka raportuar se Grabar Kitaroviq, e cila po viziton Izraelin, ka thënë se Bosnjë e Hercegovina "është shumë e paqëndrueshme dhe se në disa aspekte e kanë marrë përsipër njerëz të lidhur me Iranin dhe organizata terroriste". Po ashtu, Grabar Kitaroviq ka deklaruar se Bosnja "është nën kontrollin e islamit militant, i cili është dominues në përcaktimin e qëndrimeve".
Autorja e tekstit të diskutueshëm në "Jerusalem Post", gazetarja Greer Fay Cashman, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se Grabar Kitaroviq nuk i ka përmendur autoritetet në Bosnjë. "Presidentja e Kroacisë nuk ka folur për Iranin. Ajo e ka përmendur Iranin me një fjalë të vetme, të lidhur ngushtë me migrantët, që paraqiten si refugjatë dhe që në disa raste janë të lidhur me elemente të pakëndshme. Ajo nuk i ka përmendur autoritetet në Bosnjë dhe vërejtjet e saj që lidhen me Iranin dhe terroristët u referohen vetëm disa migrantëve që kanë gjetur rrugën deri në Bosnjë", ka thënë Cashman në një përgjigje me shkrim për "Radion Evropa e Lirë".
E përditshmja izraelite "Jerusalem Post" ka larguar gjatë ditës një pjesë të artikullit, në të cilin gjendeshin deklaratat e pretenduara të presidentes kroate.
E pyetur nga gazetarët nëse deklaratat e pretenduara janë të vërteta, Grabar Kitaroviq u përgjigj: "Absolutisht jo". Ajo ka thënë t'ua ketë shprehur autoriteteve izraelite dëshirën e saj për ta parë Bosnjën dhe vendet e tjera të rajonit të anëtarësuara në BE. "Nuk kam dhënë intervista dhe nuk u kam dhënë deklarata gazetarëve përveç dy konferencave për shtyp", tha presidentja kroate.
E pyetur t'i komentojë reagimet e ashpra të Bosnjës pas tekstit në "Jerusalem Post", Grabar Kitaroviq tha se "këto janë komente mbi komentet e një gazetareje. Po e përsëris, nuk e kam thënë atë".


Shijo
Pranverën
me...
Jaffa Champion PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L
Jaffa Champion


AUTOSHKOLLA
“RITMO – L”
Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

E rrallë

## Zgjohet në krevat me një gjarpër



Javën që lamë pas Melinda Major ishte në gjumë në dhomën e saj në një hotel në Memphis, Tennessee, kur ndjeu diçka që i lëvizte rreth krahut. Ajo ndodhej në qytet pasi kishte një takim me një doktor. Kur hapi sytë mendoi se bëhej fjalë për një ëndërr të keqe. Një gjarpër i hollë, i gjelbër, shtrihej në krahët e saj.

FOTO E DITES




Një tufë zogjsh shihen duke fluturuar në periferi të Minskut në Bjellorusi. /AP/

E jashtëzakonshme

## Turistja lyp para për të blerë birra e hashash




Në Shqipëri ka shumë të varfër që detyrohen të lypin para për ta siguruar bukën e gojës. Por çudia vjen nga Shkodra, një turiste në Pedonalen e Shkodrës lyp para që të blejë birra dhe bar (hashash), raporton "lapsi.al". Ajo është e ulur në një nga zonat më të frekuentuara në Shkodër dhe pa asnjë kompleks kërkon para që të blejë birra dhe hashash. Në foto dallohen dy çantat e turistes, si dhe një gotë metalike ku qytetarët mund t'i dhurojnë para.

## BARSOLETA E DITËS



- A je kon sivjet n'deti?
- Jo.
- Pse more?!
- Se doktori ma ka ndalu kripën.

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Çdo ditë në ora 15:30

### "Spider-Man Far From Home" 3D,

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 09 min

Rolet: Tom Holland, Samuel L. Jackson, Zendaya, Cobie Smulders, Jon Favreau, JB Smoove, Jacob Batalon, Martin Starr, Marisa Tomei, Jake Gyllenhaal

Regjia: Jon Watts







Çdo ditë në ora 17:30

### "THE LION KING" 3D

Aventurë/Dramë; 1 orë 58 min

**Rolet:** Donald Glover,Seth Rogen, Chiwetel Ejiofor, Beyonce Knowles-Carter, James Earl Jones, Alfre Woodard, John Oliver
**Regjia:** Jon Favreau

Në ora 19:30 dhe 22:00

### "HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

**Rolet:** Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.
**Regjia:** David Leitchu







Nga dt. 08.08.2019

### "THE ANGRY BIRDS MOVIE 2"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj

**Regjia:** Thurop Van Orman

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Përgjatë gjithë ditës sot do të jeni në funksion të impenjimeve profesionale. Ndërkohë mbrëmja do t'ju gjejë në një ambient të ri.



**DEMI**
Çdo mjet ose kompromis i momentit do t'ia vlejë që ju të fitoni lirinë e mendimeve. Nuk doni të jeni peng i klisheve të të tjerëve dhe do të dini si të veproni.



**BINJAKËT**
Jeni zgjuar me ide mjaft të turbullta sot sa i përket një probleми të caktuar që duhet ta zgjidhni patjetër. Mund edhe të devijoni totalisht gjatë pasdites.



**GAFORRJA**
Ngado që po dëgjoni plane për pushime juve po ju pëlqen kjo lloj ndjesie në ajër. Shumë shpejt do të niseni edhe ju në pushime.



**LUANI**
Keni mjaft probleme me punën ose biznesin tuaj dhe kjo nuk është periudha më e mirë për t'i zgjidhur.



**VIRGJËRESHA**
Edhe pse mund të keni momente që luhateni në idetë tuaja, në përgjithësi çdo gjë sot shkon shumë më mirë seç e mendonit.



**PESHORJA**
Planetët duket sikur luajnë me ju sot duke ju afruar ose duke ju larguar në momente të caktuara nga objektivat tuaja parësore.



**AKREPI**
Po ëndërroni për detin sot sepse nga ritmet e ditës po e kuptoni që në krahasim më të tjerët, pushimet për ju janë ende larg.



**SHIGJETARI**
Sot dikush do t'ju kujtojë që jeta ka edhe detyrime dhe përgjegjësi që duhet të merrni mbi vete. Deri më tani keni qenë të qetë nga kjo anë.



**BRICJAPI**
Ndjeheni të ngarkuar emocionalisht këto kohë dhe doni patjetër të pushoni. Partneri nuk po ju ndihmon aspak për të kaluar këtë fazë tensioni.



**UJORI**
Nuk është se jeni në kohët tuaja më të mira dhe këto ditë do t'ju vërtetojnë që gjithçka po shkon keq. Mbase nga ngarkesat që keni në punë çdo gjë ju bën të nervozoheni.



**PESHQIT**
Më mirë se kaq nuk mund t'ju shkonte. Shijojini këto ditë sepse do t'ju vijnë të tjera me mjaft tension dhe debate.

# Jennifer Lopezi nuk ka vozitur kurrë në jetë



Jennifer Lopezi ka zbuluar se ajo kurrë nuk e ka drejtuar një makinë. Këngëtarja 50-vjeçare realizoi një video e cila tregon herën e parë duke i dhënë një makine për nder të ditëlindjes së saj gjatë javës së kaluar. Një video shfaq të fejuarin e saj Alex Rodriguez duke e befasuar atë me një Porsche 140 mijë dollarë.

# Vajza e Brad Pittit duke u rritur i ngjan edhe më shumë atij







Shiloh Jolie-Pitt po rritet para syve të publikut. Vajza 13-vjeçare e Braditit dhe Angelinës po rritet para syve. Ajo veshi një kostum shumë 'cool' derisa shëtiste me nënën dhe motrën e saj, Zahara. Mund të mos duket e besueshme, por tani Shiloh duket si një miniversion i Brad Pittit. Vetëm shikoni flokët bionde dhe buzëqeshjen e saj.




# Lady Gaga kapet duke u puthur me të dashurin e ri

Lady Gaga me sa duket është në lidhje me Dan Horton. Dyshja janë parë duke u puthur. Këngëtarja 33-vjeçare dhe 37-vjeçari u panë bashkë në një restorant në California, ku edhe u kapën duke ndarë çaste intime. "Ata po putheshin edhe kur po flisnin", ka treguar një burim për "People". Lady Gaga së fundmi ishte e lidhur me Christian Carino, por u nda gjatë promovimit të filmit të saj "A Star Is Born".



# Gucci Mane do t'i japë 10 000 dollarë në muaj për kujdestarinë e fëmijës



Gucci Mane e ka zgjidhur problemin për kujdesin e fëmijës së tij, duke rënë dakord ta paguajë nënën e djalit të tij me rreth 10 000 dollarë në muaj. Reperi 39-vjeçar do të paguajë edhe transport për Sheena dhe djalin e tyre, Keitheon. Kjo marrëveshje u arrit përmes gjykatës. Keitheon ka lindur në vitin 2007. Gucci aktualisht është martuar me modeluesen Keyshia Ka'Oir.

# MKRS-ja jep çmimet për kinematografi

Çmimi Vjetor për Kinematografi është ndarë në mes të regjisores Burbuqe Berisha dhe aktorit Kushtrim Hoxha, ndërsa çmimi për Vepër Jetësore "Bekim Fehmiu" në fushën e kinematografisë iu dha poetit dhe kritikut letrar Azem Shkreli - postmortem. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se ministria që drejton ka një përkushtim më të madh për aktorët



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 31 KORRIK- Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, të mërkurën në një ceremoni solemne ka bërë ndarjen e Çmimit Vjetor për Kinematografi dhe Çmimit Kombëtar për Vepër Jetësore "Bekim Fehmiu".

Çmimi Vjetor për Kinematografi ndahet në mes të regjisores Burbuqe Berisha dhe aktorit Kushtrim Hoxha, ndërsa çmimi për Vepër Jetësore "Bekim Fehmiu" në fushën e kinematografisë iu nda poetit dhe kritikut letrar Azem Shkreli - postmortem.

Sipas vendimit për ndarjen e Çmimit Vjetor për Kinematografi, regjisorja Burbuqe Berisha dhe aktori Kushtrim Hoxha shpërblehen me vlerë monetare prej 1 250 eurosh, ndërsa Çmimi Kombëtar për Vepër Jetësore "Bekim Fehmiu" në fushën e kinematografisë, i cili iu nda poetit dhe kritikut letrar Azem Shkreli - postmortem, shpërblehet me vlerë financiare prej 5 000 eurosh.

Çmimet u shoqëruan edhe me nga një pllakate dhe nga një certifikatë të nënshkruara nga ministri. Ministri Gashi ka thënë se përkrahja e MKRS-së për artistët do të vazhdojë. "Besoj se kemi pasur një juri profesionale për t'i vlerësuar veprat dhe kemi ardhur deri te kjo ceremoni, për t'i ndarë këto çmime dhe është një ditë shumë e rëndësishme sepse gjithë ato rezultate që kanë ndodhur në industrinë e filmit të Kosovës natyrisht se sot shpërblehen", ka thënë ai.

Gashi ka thënë se për këto rezultate kanë rritur buxhetin për Qendrën Kinematografike. "Sot Ministria e Kulturës e ka një përkushtim më të madh për aktorët tanë kjo punë do të përkushtohet tashmë më shumë edhe në arenën botërore", ka thënë ministri Gashi.

Ndërkaq regjisorja Burbuqe Berisha, fituese e çmimit "Bekim Fehmiu", ka falënderuar ministrin Gashi për shpërblimet, duke u shprehur se është privilegj të marrë këtë çmim. "Jemi të lumtur që ka qenë filmi që ka pasur më së paku buxhet, por është kryer me kohë dhe ka qenë në disa festivale, ka qenë një film që është punuar me shumë përkushtim. Për mua Çmimi 'Bekim Fehmiu' është një privilegj", është shprehur Berisha.

Ndërsa djali i poetit Azem Shkreli, duke marrë çmimin në emër të babait, tha se: "Jemi të nderuar që na e keni dhënë këtë çmim. Të falënderoj ty ministër dhe gjithë stafin për ruajtjen dhe kultivimin e vlerave artistike dhe besoj ta vazhdoni këtë punë të mirë edhe në të ardhmen".

# SNOBIZMI



**Nga: Shkëlzen UKËHAXHAJ**

*Dikur njihej vetëm fjala snob,*
*Dhe nuk njihej shumë si fjalë,*
*Sepse njeriu i ngjante njeriut,*
*Sot, njeriu, më shumë ngjanë në djall.*

*Hamendem ta vizitoj psikologun*
*Ta pyes, pse jo, edhe për veten time,*
*E po t'përgjigjet, bile me keqardhje…*
*Kjo s'është më individuale,*
*Është bërë ndjenjë, bile virtuale.*
*Fare s'do të çuditem.*

*Më e keqja sëmundje e mendjes sot,*
*Dhe po sjell shumë telashe.*
*Njeriu tjetërsohet veç në shpirt,*
*Nga jashtë të duket si melaqe…*

*Do t'i besoja!*
*Sepse po të ndodhte dy a tri herë,*
*Do ta quaja marri,*
*do të gërditsha, se sjell vrer,*
*por ka rrëmbyer tërë miletin ore,*
*është bërë dukuri.*

*Andaj gjatë rrugës ndërrova mendjen*
*Keq më erdhi për snobët dhe snobizmin*
*Njerëzit janë sëmurë keq,*
*Do t'thosha nga xhepi deri te shpirti…*
*Këtë besojeni, njerëz të mirë!*

*Atëherë m'u duk vetja Sokrati plak,*
*Thash të gjej melhem për varrën,*
*Thash snobizmit t'ia qes pritën…*
*U bashkuan snobët në snobizëm.*
*Mua të shkretit më futën frikën…*

*Si çdo sëmundje që ka gjenezën,*
*Thash të shoh pak të kaluarën,*
*Si sot, edhe atëherë, kish qenë,*
*Veç atëherë melhem kish pas pëlhurën…*

*Duke fiqiruar me mend,*
*Poshtë e përpjetë*
*Ideja e diagnozës në mend më shkrepi,*

*Si duket një snob i parë nga tjetri.*

*Dhe ai duket si mos më keq*
*Kokën unjur e qafën shtrirë,*
*I sëmurë, i pakuruar…*
*Trupin e drejt, por kurrizin shtrembëruar,*
*Fytyrë zgërdhyer e i përçudnuar…*

*Rrahjet e zemrës të shpeshta i ka,*
*Fluturon nga admirimi, më i përuluri,*
*Punëtor "më i miri"…*
*Edhe kur duartroket shefin e tij,*
*Sharlatan duket, më pak njëri…*

*Si doktor gjilpëra i Faikut*
*Këtë sëmundje për ta kuruar,*
*Iu vesha punës pa përtesë…*
*Vitet kaluan duke dështuar,*
*Mbeta Sokrat i pa shpresë.*

*Por prej lufte kush largohet,*
*S'është i denjë për doktor,*
*Andaj lufta të vazhdohet,*
*I lumtur në këtë luftë,*
*Me mbet theror…*

*Njerëz të mirë!*
*Të këtij vendi të lashtë,*
*Nuk dua të besoj që jeni tjetërsuar,*
*Atëherë duhet vënë gishtin kokës,*
*Pa qenë skllav, s'duhet vetëskllavëruar…*

*Tregoju i pagjunjëzuar para servilizmit,*
*Gjunjëzoje, shkatërroje, përule*
*Të urryerin snobizëm…!*

*Një ditë e re*
*pastaj do të vij.*
*Njeriu, do të ndihet, jo veç nga mendja…*
*Njeri do të ndihet edhe në lëkurën e tij.*

*Që ta gjej udhën kjo shpresë,*
*Të gjithë bashkë ta injorojmë këtë ves,*
*Mos t'gjej vend tjetër snobizmi,*
*Le të mbijë shpirtlirizmi!!!*

*Korrik, 2019*

# Si e përjetoi Nexhmije Hoxha, sëmundjen e Pranverës... Letrat sekrete për mjekët

Isuf KALO

Një letër që më dërgonte më datën 14 prill 1981 profesor Fejzi Hoxha, me porositë aq shumë të detajuara të Nexhmijes, ndërkohë që unë shoqëroja Pranverën në Paris për një problem shëndetësor, më habiti për shkallën e metikulozitetit dhe ankthit me të cilat ajo i përjetonte të tilla probleme te familjarët dhe, në këtë rast, për të bijën e saj.

Pranvera u dërgua atje me rekomandim të obstetër-gjinekologut tonë më të mirë të asaj kohe, prof. K. G., për lindjen e fëmijës së dytë të saj me operacion. Prof. K. G., që e pati ndjekur atë gjatë shtatzënisë, e vlerësoi situatën të rrezikshme. Në kushtet e disa mungesave të mjekësisë sonë të asaj kohe, ai nuk mori përsipër t'i garantonte jetën as nënës dhe as foshnjës nëse do ta kryente ndërhyrjen në Shqipëri.

Pranvera u nis disi me urgjencë përpara datës së lindjes, e shoqëruar nga i shoqi, Klemi, një infermiere, prof. K. G., nga unë dhe oficerë të Sigurimit, me në krye Sulo Gradecin. Së pari, ajo u vendos në një apartament të rezidencës së ambasadës sonë, në pritje që konsulta e specialistëve francezë të vendoste kur duhej shtruar në spital, si dhe kohën e kryerjes së ndërhyrjes kirurgjikale.

Në këto rrethana, profesor Fejzi Hoxha më dërgoi dorazi një letër me porositë konfidenciale të Nexhmijes. Disa pasazhe të saj po i riprodhoj më poshtë, bashkë me nënvizimet, që janë origjinale:

*"Ay (prof. K. G.) natyrisht do rrijë ngjitur atje me ju, ku ta caktojë Sulua, të jetë afër, ta keni sa më shpejt, ditën e në orët e natës. Për deri sa të mbaroni punën të mos largohet as një minutë as në ndonjë vend. Sipas udhëzimeve që kam, pasi u thirra për këtë (nga Nexhmija) duhet që gjersa të jeni pa u shtruar të bëni planin si do të veprohet në rast të një urgjence të papritur, ditën ose natën?... Përveç planit të detajuar nga K. G., ti bëj planin tënd që infermierja dhe një shofer dhe ti vetë, të mos largohesh as një sekondë. Bëni planin me spitalin ku do vesh me profesorin (francez) që je marrë vesh në rast urgjence, ku do drejtohesh, të të lidhi me ndonjë asistent të aftë në mungesë të tij që ta gjesh gati ose me ndonjë profesor tjetër të besimit të tij. Ose merru vesh me Miliezin (prof. francez Pol Miliez) qysh më parë për rastin e ndonjë urgjence extreme, ditën ose natën përderisa të shtrohet që mos jeni të kapur në befasi. Kur të shtroheni shiko të lidhesh në rastin e ndonjë urgjence të paplanifikuar me profesorin e klinikës ose në mungesë të tij me ndonjë asistent më të aftë, se gjatë rojës mund të jetë ndonjë kirurg i dorës së dytë.*

*Në qoftë se nga një ose dy profesorë që do të vizitohet (shikoje këtë vetë ose konsultohu me Miliezin po të ketë divergjenca për kohën e ndërhyrjes, mos shkruaj këtu për të marrë mendim. Nuk do të dijë dhe nuk mund të vendosë kjo këndej. Të vendosi konsulta, bisedo me Miliezin) Nuk duan të dinë për divergjencat e profesorëve.*

*Të vendosi dhe të bëhet si të mendojë konsulta (Po pati divergjenca, opinionesh bisedo edhe me Miliezin, a Netterin (profesor Netter, Gjinekolog) ju e dini 'Ne nuk duam të dimë'. Kaloritë dietën, ti ato i di dhe i bën vetë. Për çështjen e anestezisë, ki kujdes shiko mos ka pasur ndonjë alergji. Bisedoje këtë edhe me dr. B.*

*Ne duam që të lindi mirë dhe interesohemi shumë edhe për fëmijën, veçse në rast që do ishte e domosdoshme të ndërhyhej para kohe për të evituar rrezikun e një komplikacioni eventual, të rëndë të mëmës, natyrisht mbi të gjitha e mbi çdo gjë na intereson jeta e mëmës. Pas lindjes është e preferueshme që të mendohet fëmija nga nëna e vet po të ketë qumësht. (Mos ti shtohet ushqimi mbi 1,800 kalori se bëhet më obeze). Në qoftë se nuk do të ketë qumësht ose do e ketë të pamjaftueshëm nuk do kemi kundërshtim për ndonjë taje. Kjo nuk ka nevojë të shtrohet në spital, mund të mbahet në shtëpinë e pritjes. Rregulloje këtë me Sulon se ai i di këto punë.*

*Në qoftë se ju planifikojnë ditën kur do të ndërhyjnë, nuk duam ta dimë në asnjë mënyrë ditën ekzakte se kur. Nuk duam të rrimë me ankth. Mund të thuhet ndoshta vetëm ka mundësi që brenda këtyre 10 ditëve prej kaq deri kaq, por jo ditën. Mos i thuaj asnjërit këtu se nuk duam të na e thonë. Kur të ketë përfunduar mirë çdo gjë na jep sihariqin. Mos e shëtit tashti as me makinë, veçse kur të ketë nevojë për analizat. Për nisjen këtu duhet të siguroheni mirë që fëmija ka mundësi të udhëtoj. Merr masat e gatishmërisë për çdo të papritur të befasishme…"*

Letra dukej sikur po ta shtrydhje kullonte alarm, ankth, frikë, pasiguri, tersllëk, befasi. Të gjitha bashkë krijonin stres kur e lexoje, por pasqyronin shqetësimin dhe preokupimin e mirëkuptuar e të pritshme prej një nëne. Për fat të mirë, në këtë rast çdo gjë shkoi mirë. Asnjë nga ato ndërlikime të papritura që parashikonte Nexhmija, si nënë e shqetësuar, nuk ndodhi. Por shumë nga ato që ajo porosiste nuk u zbatuan, sepse ishin të pazbatueshme.

Në spitale publike, ku u shtrua e sëmura, nuk zgjidhej dot cili mjek do të jetë roje dhe as zgjedh dot mes anëtarëve të një ekipi mjekësor cili prej asistentëve është më i



zoti sesa të tjerët. Edhe sikur t'i identifikonim ata me çfarë tagri do i kontaktonim dhe do t'i urdhëronim? Në Shqipëri një fjalë e saj mund të ngrinte në këmbë në çdo orë të ditës dhe të natës secilin nga ne mjekët. Por jo në Paris. Dhe jo mjekët francezë. Aq më pak ishin realiste mundësitë e konsultimit me eminenca mjekësore me famë ndërkombëtare, siç ishte prof. Miliezi apo prof. Netter, për t'u marrë mendime sa herë të na duhej ne, për probleme të tilla rutinore apo organizative që stononin me rangun dhe interesat profesionale dhe shkencore të tyre.

Kur e lexova letrën për Pranverën në Paris, më përfshiu edhe mua ankthi. Sikur ndonjë nga ato aksidente që Nexhmija parashikonte të ndodhte vërtet për shkak të mosndjekjes e plotësimit të porosive të saj, do të ishte me pasoja për ne që e shoqëronim të bijën. Një episod i vështirë, me të papritura për mua, ishte kur në takimin e parë që pata me profesor Miliezin, fill pa mbërritjes sonë në Paris, ai propozoi si obstetër–gjinekolog për t'u marrë me rastin e Pranverës, të birin e tij, dr. Zhak Miliez, i cili, disa kohë kishte punuar në Algjeri, ku edhe ishte martuar me një vendase dhe vetëm vonë ishte kthyer në Paris. Unë u stepa. Në rininë e tij Zhaku njihej disi si rebel, nga ata hipitë me mjekër, që kur vinin si turistë në Shqipëri i detyronim ta rruanin mjekrën që në aeroport. Ndonëse tashmë i pjekur, baba me tri vajza, ai ende nuk kishte grada e tituj shkencorë e pedagogjikë. Pritshmëritë dhe pretendimet e prindërve të Pranverës ishin përkundrazi, që rasti i saj t'i besohej një profesori specialist me emër të madh. Zhaku nuk ishte i tillë. Nga ana tjetër, zgjedhjen ata ia patën lënë në dorë Miliezit si mik. Çfarë përgjigje të jepja?

Po ta refuzoja propozimin e Miliezit mund të qortohesha nga prindërit e Pranverës se kisha ofenduar një mik të Shqipërisë. Po ta pranoja mund të qortohesha për të kundërtën po nga ata, pse ia besova pacienten një mjeku të rëndomtë, pa prestigj të lartë profesional. *"Pse për një doktor si Zhaku e dërguam ne vajzën deri në Paris?"*

Profesor Miliezi, psikolog dhe diplomat i thekur, me sa duket e pikasi hutimin dhe mëdyshjen time: "Unë mendova si më mirë e për më shumë siguri të merrej me pacienten dikush i familjes, por edhe që ta dini Zhaku punon në një ekip me profesor Suron, i cili është një nga eminencat e obstetrikë–gjinekologjisë franceze. Mund t'ia lëmë në dorë edhe vetëm profesor Suros, por…" Pati një pauzë hezitimi, pastaj, me ton dashamirës, të përzier me pasiguri, tha: "Mirëpo është diçka që duhet t'ua them: i ati i Suroit ka qenë kolaboracionist me gjermanët (Miliezi vetë, përkundrazi, pat qenë gjatë luftës aktivist i shquar i rezistencës). Kjo, për ne në Francë, është *non sens,* nuk përbën asnjë problem, por nuk di sa e pranueshme do të ishte kjo zgjedhje nga prindërit e saj." Dhe pasi tha këtë, ngriti energjikisht kokën sikur po më testonte duke më parë si me ironi në sy.

Unë nuk u surprizova. "Mëkatet biografike" të trashëguara në familje vlenin për luftën e klasave në Shqipëri, kurse Franca dhe bota e qytetëruar kishte dekada që nuk merrej me to. Përfshirja e profesor Suros më ngrohu. U ndjeva i çliruar. Binomi "Suro – Zhak" na i siguronte të dyja: "Ekspertizën e duhur dhe Miqësinë të pacenuar". Ishte zgjidhje ideale. Disi i ngazëllyer iu përgjigja shkurt, por menjëherë: "Shumë mirë zoti profesor. Ju falënderoj thellësisht". Në mbrëmje, në komunikim telefonik me Nexhmijen, e vumë në dijeni për çka vendosëm. Fillimisht edhe ajo u habit për zgjedhjen e Zhakut nga Miliezi, por fatmirësisht nuk pati asnjë objeksion për t'ia lënë në dorë problemin e së bijës djalit të kolaboracionistit…

Atëherë pata admirim për këndvështrimin e duhur të saj. Zemra e dhembshur prej nëne doli mbi parimet e ngurta të militantes. Por shumë vite më pas, kur u mësua qëndrimi që Nexhmija kishte mbajtur ndaj një nëne tjetër, Liri Belishovës, ish-udhëheqëse komuniste dhe shoqe lufte e saj, tashmë e internuar, e cila i qe lutur përmes një letre Nexhmijes, si grua e nënë, që ta ndihmonte ta lejonin të vizitonte e t'i qëndronte pranë vajzës së saj, që po ndahej nga jeta në moshë shumë të re nga një sëmundje e pashërueshme në Spitalin Onkologjik të Tiranës, m'u duk e pabesueshme që Nexhmija ta kishte refuzuar.

Për fat të keq, kjo pat ndodhur vërtet. Përtej të gjitha dallimeve dhe ndasive mes tyre, amësia ishte ndjenja instiktive që i bashkonte ato dy gra të pazakonta. Nuk di të them pse ndodhi ashtu. Pse Nexhmija zgjodhi të tregohej ndaj saj militante, e ngurtë, e rreptë, ndërkohë që e kisha parë të falte dhembshuri si grua, si nënë, si vjehërr, si motër dhe si gjyshe.

I zhgënjyer e i befasuar, nuk di si ta shpjegoj atë që ndjeva, e akoma më pak si ta justifikoj atë qëndrim të Nexhmijes. Si qenkej përzier dhembshuria drithëruese prej gruaje dhe nëne për fëmijët dhe të dashurit e saj brenda të njëjtës zemër tek i njëjti person, me egërsinë e dufin inatçor prej militanteje të indoktrinuar ndaj një nëne tjetër aq shumë fatkeqe?

Ndoshta rrezja e ndjenjave altruiste dhe pozitive të saj, e shtrirë gjerësisht me dalldi në vitet e rinisë, ishte tkurrur nga dështimet dhe zhgënjimet e "tradhtive" të përjetuara dhe ishte kufizuar vetëm brenda rrethit të ngushtë familjar e fisnor të saj. Dhe të besnikëve të sinqertë, tashmë aq të rrallë.

Libri BLLOKU/ GAZETA SHQIP

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com
Montimi
Servisim
Porosi



Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Selmani: Paraqitja e Feronikelit në Evropë ishte e mirë

Trajneri Agron Selmani ka thënë për "Epokën e re" se paraqitja e Feronikelit dhe Prishtinës në arenën ndërkombëtare ka qenë relativisht e mirë. Për ndeshjen ndaj Slovan Bratislavës, Selmani shprehu mendimin se në radhët e kampionëve të Kosovës pati një lodhje. "Klubet e Kosovës, e sidomos Feronikeli, janë prezantuar mirë në arenën ndërkombëtare. Në ndeshjen e fundit pati një lodhje, por më shumë edhe një ngarkesë emocionale, të cilën njerëzit në klub është dashur ta menaxhojnë më mirë", ka thënë Selmani

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 31 KORRIK - Të martën në mbrëmje edhe zyrtarisht futbolli i Kosovës e përfundoi aventurën në arenën ndërkombëtare për këtë edicion, pasi Feronikeli nuk arriti ta përmbysë rezultatin e ndeshjes së parë ndaj Slovan Bratislavës (2-1), duke pësuar humbje edhe në ndeshjen e dytë (0-2), e cila është zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë.

Për dallim nga "Nikli", nënkampionia e Kosovës, Prishtina, aventurën e kishte mbyllur më herët në Ligën e Evropës dhe tash pret fillimin e edicionit të ri në Superligë.

